



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm - Kancelarija Generalnog Sekretara - Office of the
Secretary General

Nr. 59 / 2026
Datë: 28 / 05 / 2026

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, duke u bazuar në nenin 11 dhe 17 të Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, si dhe bazuar në nenin 4, nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe nenin 8 paragrafi 2 nën paragrafi 2.10 të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe nenit 26 dhe 44 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet pjesërisht kërkesa për Qasje në Dokumente Publike, e parashtruar nga znj. Flandra Marmullaku;
2. Obligohet Zyrtari përgjegjës për Qasje në Dokumente Publike në Ministrinë e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Znj. Marmullaku, më datë 21.05.2026, ka parashtruar në Ministrinë e Drejtësisë kërkesën me numër të protokollit 02-706, për Qasje në Dokumente Publike lidhur me krijimin e një përdoruesi për qasje në Databazën për Evidentimin e Rasteve të Dhunës në Familje.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe vlerësimit të bazës ligjore në fuqi, është konstatuar se kërkesa ka të bëjë me mundësimin e qasjes së kufizuar në databazë për qëllime analitike dhe hulumtuese, në kuadër të hartimit të raportit analitik pesëvjeçar (2021-2025) për

rastet e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore, proces i mbështetur nga UN Women dhe i realizuar nga kompania e angazhuar Data4X.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës janë zhvilluar konsultime me zyrtarët përgjegjës të Ministrisë së Drejtësisë dhe zyrtarët e Divizionit për Teknologji Informative, me ç'rast është vlerësuar se gjenerimi manual i raporteve statistikore për periudhën 2021–2025 paraqet ngarkesë të konsiderueshme operative dhe teknike për sistemin aktual.

Andaj, bazuar në vlerësimet teknike dhe administrative, është konsideruar e arsyeshme krijimi i një përdoruesi me qasje të kufizuar, me qëllim të realizimit efikas të procesit të analizës së të dhënave, duke garantuar njëkohësisht mbrojtjen e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit institucional.

Qasja do të jetë e kufizuar duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personal në gjenerimin dhe përdorimin e të dhënave statistikore për qëllime analitike dhe hulumtuese, pa mundësi ndërhyrjeje në sistem apo qasje në të dhëna të ndjeshme identifikuese, përtej autorizimeve të përcaktuara nga Ministria e Drejtësisë dhe legjislacioni në fuqi.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat dhe në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ridvan Hoti

Sekretar i Përgjithshëm



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi kërkuar ka të drejtë të parashtrojë ankesë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh në Agjencinë për Informim dhe Privatësi.

Vendimi i dërgohet:

- Znj. Flandra Marmullaku;
- Kabinetit të Zëvendëskryeminstres dhe Ministres në detyrë të Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Zyrtares përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë për Qasje në Dokumente Publike;
- Zyrtarëve të Divizionit për Teknologji Informative;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.